

## TÜV NORD CERT –

## Standarti ISO 45001:2018

## Sistemi I Manaxhimit te Sigurise dhe Shendetit ne Pune- Pikeveshtrim Sistematik



## ISO 45001:2018 HSMS-OHSAS



Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) deklaroi se çdo vit, me shume se 2.5 milionë njerëz në botë humbasin jetën për shkak të aksidenteve në vendin e punës.

Me gjithë s tatistikat në lidhje me numrin e aksidenteve me fatalitet në pune, Ligjet, Rregulloret e aplikuara dhe Standartet e Manaxhimit te Shendetit dhe Sigurise ne Pune po krijojne nje kuader ne permiresim, ndergjegjesim dhe kane zvogeluar aksidentet fatale te punonjesve.

Standardi i ri ISO 45001:2018 u publikua më 12 Mars 2018 dhe aplikohet ne te gjithe boten. Ai zëvendëson BS OHSAS 18001:2007

## Përdorimi i vazhdueshëm i ISO 45001

synon të arrijë përmirësimin e vazhdueshëm të profesionalizmit të trajtimit të shëndetit dhe sigurisë në pune.

## Avantazhet e certifikimit

Në shumë sfera, sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë tashmë japin një kontribut serioz në parandalimin e lëndimeve dhe sëmundjeve. Sot ato tashmë janë marrë si të mirëqenë shumica e organizatave .

Kalimi në ISO 45001:2018 kërkon kohë shtesë dhe përpjekje. Por angazhimi ia vlen. Certifikimi ka një ndikim pozitiv kur bëhet fjalë për zhvillimin e kompanisë e cila duhet të përfitojë nga kjo mundësi që ben me te qëndrueshme dhe fitimprurese nga pikëpamja financiare.

Struktura e Nivelit të Lartë e këtij standardi, gjithashtu, bën të mundur kombinimin e ndryshëm të aspekteve si cilësia, mjedisi dhe manaxhimi I energjise Ku Standard, për cka perfaqeson, rrit nivelet e pranimit me punonjësit.

## Struktura e ISO 45001:2018 merr ne konsiderate

- strukturë identike për të gjitha sistemet e menaxhimit
- përdorimi i njëjtë i teksteve dhe termave bazë
- standard më të lehte për t'u kuptuar
- zbatimin më efikas të integruar me sistemet e menaxhimit

## Dhjetë pikat kryesore të ISO 45001:2018:

- 1 Qellimi/Fusha e aplikimit
- 2 Referenca
- 3 Terma dhe perkufizime
- 4 Konteksti i Kompanise
- 5 Leadership dhe pjesëmarrja e punonjesve
- 6 Planifikimi
- 7 Mbeshtetja
- 8 Veprimtaria
- 9 Vleresimi i performances
- 10 Permiresimi

## Cfare duhet te konsiderojme ne lidhje me rreziqet dhe mundesite ne kontekstin e ISO 45001?

ISO 45001 ndjek pikepamjen e të menduarit qe bazohet në vleresimin e rrezikut.

Kjo do të thotë që organizatat duhet të marrin parasysh rreziqet dhe mundësitë e tyre më me kujdes se më parë dhe t'i identifikojnë ato në përputhje me rrethanat. Në vend që të reagojnë ndaj pasojave që kanë ndodhur tashmë, organizatat duhet të bëjnë plane specifike paraprakisht se si duhet të trajtohen efektet e mundshme. Vlerësimi i rreziqeve dhe mundësive dhe veprimet korigjuese dhe parandaluese, mund të lidhet, për shembull, me investime (makineri të reja), infrastrukturë të brendshme, inovacione apo monitorim i vazhdueshëm furnitresh.

**Elvis Pazaj**

Lead Auditor:

ISO 9001; ISO 14001; ISO 45001

R.A. Soc Resp. ISCC EU/GHG Auditor

**TÜV NORD CERT GmbH**

Systemzertifizierung / System Certification

Am TÜV NORD Bulgaria -TUV NORD GROUP  
1005 Tirana,  
Albania

**M** +355 (0)692031015**F** +355 (0)445 31015**E** [epazaj@tuev-nord.de](mailto:epazaj@tuev-nord.de)

## Pjesëmarrja dhe konsultimi

Kompania duhet të sigurojë që të kete krijuar konditat për pjesëmarrje dhe konsultim të punonjësve dhe përfaqësuesit e tyre, nëse ka, në lidhje me vendimet që i përket sistemit të menaxhimit të OH&S.

Kompanite do të duhet, gjithashtu, të aplikojnë një proces për identifikimi i mundësive për përmirësimin e profesionalizmit të personave pergjegjes pershendetin dhe sigurinë.

Mundësi të tilla lindin nga:

- ndryshimet organizative
- vendime per eliminimin e rreziqeve për shëndetin dhe sigurinë ne vendin e punes
- përshtatja e kushteve të punës me nevojat e punonjësit

## Procesi i Auditimit

Brenda procesit të auditimit, është shumë e rëndësishme të sigurohet që pjesëmarrësit sipas kërkesave të paragrafeve të standartit dhe rregullat e akreditimit të merren parasysh. Në ISO 45001, Pjesëmarrësit duhet të percaktohen qartësisht me rrolet e tyre specifike:

- Manageri i personelit me pergjegjesine ligjore per Shendetin dhe sigurine ne pune,
- Personeli i manaxhimit qe merret me personelin me kohe te perhershme dhe te perkoheshme
- Perfaqesuesi i punetoreve me pergjegjesine per Sigurine dhe Shendetin ne Pune
- Personeli qe monitoron shendetin e punonjesve
- Ne procesin e auditit, Manaxhmenti dhe Punonjesit duhet te intervistohen ne vendin e punes-vendin e auditimit.

